



# NJERIU PA DEMOKRACI



# SI PESHKU PA UJË

## POPULLI SOT

LULZIM (12), ERA (11), ERZA (12), ELISA (11), ELTIJONA (11)



Më mirë vetëm apo të gjithë së bashku? Ne mendojmë se është më e drejtë dhe më mirë të udhëheqim që të gjithë!

**Të dashur fëmijë, edhe ne sikurse ju, jetojmë në një vend demokratik. Por, ne kemi për detyrë që të mësojmë për këtë lloj të qeverisjes. Prandaj, kemi dëshirë t'iu tregojmë se çfarë kemi mësuar ne sot**

Përshëndetje për ju, lexues të artikullit tonë. Ashtu siç mund ta shihni edhe në nëntitull, ne si qytetarë demokratikë e konsiderojmë si detyrë informimin e qytetarëve për veçantitë e kësaj formë të qeverisjes. Të gjithë qytetarët duhet të dijnë për të mirat që na i sjell demokracia. Demokracia rrjedh prej dy fjalëve të vjetra greke: „demos“ dhe „kratos“. „Demos“ do të thotë popull, kurse „kratos“ do të thotë qeverisje. Kur bashkohen këto dy fjalë, formohet fjala më e ëmbël për veshët tanë, *demokraci*. Kjo formë e qeverisjes lindi në vitin 507 p.e.s., në qytetin e Athinës. Format më të përhapura të saj janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese. Por, ku dallojnë në mes vete?

Dallimi qëndron në atë se në demokracinë e drejtpërdrejtë, qytetarët udhëheqin në mënyrë të drejtpërdrejtë,

e në kohët e lashta edhe duke u takuar me njëri-tjetrin fytyrë më fytyrë. Kurse, në demokracinë përfaqësuese qytetarët votojnë për përfaqësuesit e tyre. Mirëpo, si funksionon kjo formë e demokracisë? Së pari, edhe shteti ynë Kosova ka demokraci përfaqësuese që nga viti 2008. Ky shtet ka afërsisht 2 milionë banorë dhe kur vie koha për të zgjedhur, ne votojmë për vetëm disa persona të cilët na përfaqësojnë të gjithëve. Ata i quajmë deputet/e. Përveç demokracisë, në botë ka edhe forma të tjera të qeverisjes. Njëra ndër to është autokracia. Tani do të tregojmë një histori nga një shoqe jona, e cila mori rolin e një mbretëreshë. Tung për juve. Unë jam Mbretëresha Eltjonë dhe jetoj në një vend autokratik të quajtur *Qyteti i Kaltër*. Në këtë vend pushteti më takon mua, të cilin e kam trashëguar nga familja ime. Por, mua nuk më pëlqen të zotëroj e vetme dhe dëshiroj që qyteti im të jetë qytet demokratik. Kështu, qytetarët do të mund të vendosin vetë për veten e tyre dhe do të jetojnë në barazi dhe liri.



Buzëqeshja tregon se sa mirë është të mësoh gjëra të reja



Fotografia e gazetarëve tejet profesionistë



# TË AKTIVIZOHEMI PËR TË MIRËN E VENDIT

RINESA (12), ERIGENT (11), ERLIS (12), AJETE (12), ALTINA (12), ADEM (11)

## TUBIMET



### Qytetarët e mirë janë gjithmonë aktiv. E ju, mësojeni se si mund të jemi ne aktiv në vendin tonë

Në organizatën TOKA është një projekt në të cilin mund të bësh punë vullnetare për vendin tënd dhe të bëhesh Super-Vullnetar. Të rinjtë e Kosovës implementojnë idetë e tyre duke rregulluar komunitetin e tyre. Për shembull, në një park të Fushë Kosovës, Super-Vullnetarët e TOKA-s kanë vendosur shporta për hedhjen e mbeturinave. Ky aktivizim i tyre ndikon që të gjithë qytetarët të cilët jetojnë në Fushë Kosovë të përfitojnë shumë gjëra. Ky shembull ilustron se si ne mund të bëhemi qytetarë aktiv dhe të zhvillojmë për mirë vendin tonë.

Përpos punës vullnetare, aktiv mund të jemi edhe duke qenë pjesëmarrës në zgjedhje, tubime dhe protesta paqësore. Gjithashtu, mund ta pastrojmë ambientin apo edhe të ndihmojmë të tjerët në forma të ndryshme dhe sipas nevojave të tyre.

Një shtet mbahet nga qytetarët e tij. Sidomos kur është fjala për demokracinë. Ne jemi themeli i shtetit tonë dhe duhet të punojmë e të angazhohemi sa më shumë. Demokracia na siguron të drejtat që i kemi. Por, nuk duhet të harrojmë edhe përgjegjësitë ndaj vendit tonë. Ne sot kuptuam se aktivizimi i qytetarëve ka aq shumë vlerë sa që nuk mund të përshkruhet dot me fjalë. Shpresojmë që ju ta keni kuptuar këtë fakt dhe të aktivizoheni maksimalisht për vendin tonë të mirë, Kosovën.



Këtu jemi gjatë punës sonë në grup. Me shumë entuziazëm dhe përkushtim e shkruajtëm këtë artikull për ju




Secili nga ne ka dhënë kontribut për këtë artikull. Sot ishim gazetarë të Kuvendit të Kosovës



Mbrojtja dhe pastrimi i ambientit është shumë e rëndësishme për shëndetin tonë dhe shëndetin e të tjerëve




E drejta e familjes është e drejtë që i ofrohet secilit, ashtu si çdo e drejtë tjetër në demokraci



Në të kaluarën, gratë nuk kanë pasur të drejtën e votës. Mirëpo, sot të gjitha gratë votojnë, sepse edhe ato gëzojnë këtë të drejtë



Si frytet e shumta të një peme, ashtu edhe elementet e demokracisë zbukurojnë jetën tonë. Pa këto elemente, as demokracia nuk do të ishte e mundur



Vetëm duke mësuar dhe duke fituar dituri, ne mund të jemi të suksesshëm për vete dhe për vendin tonë



Sikur të mos ishte demokracia, ne nuk do të jetonim në paqe e as në liri



# GAZETARËT NË DEMOKRACI

BLEND (12), LEONIDA (12), SELIM (12), ERZA (12), DJELLON (12), ELDA (11)



## Çdo qytetar i cili jeton në një shtet demokratik, ka të drejtë të zgjedh profesionin të cilin ka dëshirë ta ushtroj

Sot, me datën 11.05.2018, kemi ardhur në Prishtinë me qëllim që në Punëtorinë „Demos-ti“, të mësojmë më shumë për demokracinë dhe për temat e tjera që që lidhen me të. Këto informata që ne i morëm, na pëlqyen shumë. Prandaj, ne vendosëm që me këto të dhëna ta shkruajmë një ngjarje të cilën ju do të mund ta lexoni në vazhdim. Ngjarja jonë ka të bëjë me një libër, i cili quhet „Demokracia“. Në këtë libër, personazhet kryesore janë qytetarët. Ata e kanë rolin kryesor, sepse ata janë personat të cilët vendosin se çfarë do të ndodhë në këtë libër.

Personazhet kryesore, brenda librit kanë shumë të drejta, të cilat mund t'i shfrytëzojnë deri në atë masë sa nuk e pengojnë njëri-tjetrin. Njëra ndër këto të drejta është e drejta e zgjedhjes së profesionit.

Ashtu siç e cekëm më lart, edhe kjo e drejtë ka kufijtë e saj. Kjo do të thotë se qytetarët nuk kanë të drejtë ta dëmtojnë njëri-tjetrin. Për shembull, nëse dikush zgjedh të jetë gazetar, ai ka plotësisht të drejtë që ta bëjë një zgjedhje të tillë. Me këtë të drejtë, lindin edhe përgjegjësitë ndaj këtij profesioni. Njëra ndër to është se gazetari nuk duhet të jap lajme apo informata të pavërteta.

Edhe ne sot papritur u bëmë gazetarë. Qëllimi ynë

është që t'i njoftojmë qytetarët për profesionin tonë, gjegjësisht për median.

Media është mjet informativ, të cilën ne si gazetarë e përdorim për të shpërndarë lajme në të gjithë botën. Media ndahet në dy grupe: media të shkruara dhe ato elektronike. Ato të shkruara janë: gazetatat, revistat, librat, lekturat, romanet, etj. Ndërsa, ato elektronike janë: televizioni, telefoni, radio, kompjuteri, etj.

Media na ndihmon neve që të marrim informata të ndryshme, siç është për demokracinë, por edhe për çështje të tjera. Ajo është e rëndësishme për neve si nxënës, sepse neve na duhet të marrim edhe informata shtesë për të gjitha lëndët mësimore, të cilat i mësojmë në shkollë. Këto informata do të na shërbejnë për tërë jetën.



Përfaqësuesit e gazetës së përditshme



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dëshmorët e Baballoqit“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Baballoq, Deçan